



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.02/2017

Prishtinë, më 18 tetor 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Frashër Krasniqi, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Mungoi: Miljana Nikoliq, Mytaher Haskuka, Mirjeta Kalludra dhe Luljeta Veselaj-Gutaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Skender Reqica Ministër-MPMS, Izedin Bytyçi sekretar-MPMS, Minire Begaj-drejtoreshë e Departamentit Ligjor-MPMS, Bahri Xhaferi- drejtor i Departamentit për Pensionet, Basri Berisha-IAP dhe Florije Kryeziu-UNICEF, Teuta Prekazi UN Human Rights, Agron Gashi -Zyra Ligjore e Kryeministrit dhe Haki Shatri-këshilltar i Kryeministrit.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit .

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme;
2. Raportim në Komision (i ftuar ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Skender Reçica.);
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10 tetor 2017, u miratuan pa vërejtje.

2. Raportimi në Komision nga z. Skender Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Duda Balje, tha se duke pasur parasysh vështirësitë që janë në proces të zbatimit të Ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë si dhe të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, e kemi parë të arsyeshme që në këtë mbledhje të raportojë lidhur me këto çështje, ministri i MPMS-së.

Skender Reçica, tha se sa i përket zbatimit të këtyre dy ligjeve Ministria që ai drejton është institucion kryesor që merret me këtë çështje.

Që nga miratimi i këtij ligji, ministria ka ndërmarre veprime konkrete, ka hartuar rregulloren për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e komisionit, për caktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të këtyre personave, e cila u miratua në mbledhjen e qeverisë së mbajtur më 26 mars 2017. Pastaj është miratuar edhe udhëzimi për formën dhe përmbajtjen e librezave identifikuese si dhe mënyra e mbrojtjes së regjistrit për këta persona me datën 24 prill 2017.

Deri tani janë pranuar gjithsejtë 1550 kërkesa, 100 prej tyre i janë nënshtruar vlerësimit në komision, ndërsa të tjerat janë në proces. MPMS-ja, ka përgatitur propozim-vendimin për caktimin e kompensimit të këtyre personave dhe kujdestarëve personalë. Ky propozim i është dorëzuar Zyrës së Kryeministrit, për shqyrtim dhe miratim, dhe pas miratimit të tij do të fillojmë me ekzekutimin e kompensimit.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se kjo çështje e ka qenë brengë edhe në legjislaturën e kaluar, duke pasur parasysh vonesën e nxjerrjes së udhëzimeve administrative dhe në mungesë të tyre nuk kemi zbatim të ligjit.

Në vazhdim ajo u interesua të dijë lidhur me veprimet tjera të ndërmarra për zbatimin e këtij ligji, si dhe për çështjen e projeksioneve buxhetore në Projektligjin për buxhetin për vitin e ardhshëm, a është para buxhet për implementimin e këtij ligji, sepse nga qeveria e kaluar në këtë drejtim, kishim vetëm premtime.

Teuta Haxhiu, tha se u përmend çështja e pajisjes së këtyre personave me librezë, a nuk kanë qenë të pajisur më parë këta persona me librezë, dhe kur është afati i fundit për këtë çështje, a mundet me qenë kjo kohëzgjatje vetëm për të zvarritur çështjen e kompensimit të tyre.

Skender Reçica, duke u ndërlidhur në çështjet e parashtruara, theksoi se pagesat do të bëhen në mënyrë retroaktive, prej ditës së aplikimit, ndërsa sa i përket çështjes së librezave është me kompetent të flas drejtori i Departamentit për Pensionet.

Bahri Xhaferi, tha se në momentin kur personi fiton të drejtën për kompensim prej atij momenti pajiset edhe me kartelë, pa vlerësim mjekësor nuk kemi obligim ligjor që t'i pajisim me kartela, dhe shtoi se këta persona për herë të parë pajisen me kartela. Vlerësimin mjekësor planifikojmë ta përfundojmë në fund të muajit nëntor, ndërsa në muajin dhjetor të fillojmë me kryerjen e pagesave, arsye e vetme pse nuk ka filluar zbatimi i këtij ligji ka qenë mosrishikimi i buxhetit për vitin 2017.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se ka raste që janë paraqitur në qendrat për punë sociale nëpër komuna për të plotësuar formularin për aplikim, por palët janë kthyer sepse Qendrat për Punë Sociale, nuk kanë qenë të gati të fillojnë.

Bahri Xhaferi, tha se Qendrat për Punë Sociale nuk administrojnë këtë skemë, por Zyrat Rajonale të Pensioneve, të cilat shtrihen në 7 qendra rajonale.

Saranda Bogujevci, pyeti a ekziston afat sa i përket çështjes së pajisjes me kartela, apo personat që kanë nevojë për to mund të aplikojnë gjatë gjithë kohës, dhe a ka ndonjë bashkëpunim mes qendrave të mjekësisë familjare, ku munden me qenë formularët aty sepse është me rëndësi që formularët të jenë të qasshëm për personat që kanë nevojë, përveç në ato 7 rajone.

Lirije Kajtazi, tha se përfaqësuesit e ministrisë prezantuan anën reale dhe u tha se ka qenë rishikimi i buxhetit pengesë për të filluar zbatimi i këtij ligji, por tani së bashku po mundohemi të bëjmë më të mirën e mundshme. Kur është miratuar buxheti për vitin 2017, si komision kemi bërë një shkresë Komisionit për Buxhet dhe Financa, që të parashihen mjete në buxhet, por atyre mjeteve financiare, për interesa të ndryshme po u ndërrohet destinacioni . Sidoqoftë, me një korrektësi të përbashkët mund të avancojmë më tutje.

Bahri Xhaferi, tha se, pa u dhënë vlerësimi nga komisioni mjekësor nuk kemi bazë ligjore të pajisim dikë me librezë. Parashtrimi i kërkesë është mënyrë e thjeshtë, qendrat e Mjekësisë Familjare nuk kanë kompetencë të merren me këtë punë. Pala duhet të paraqitet në qendër rajonale dhe të parashtrijë kërkesën, ku më pas fillon procedura e shqyrtimit dhe e vlerësimit. Në rast se pala nuk mund të paraqitet në qendër rajonale të pensioneve, atëherë formojmë ekipe mobile, të cilat shkojnë në shtëpi të personit dhe e bëjnë vlerësimin.

Izedin Bytyçi, tha se nuk ka kufizim të afatit për të aplikuar, afati është i hapur, kurdo që pala paraqitet për aplikim.

Duda Balje, në fund të diskutimeve për zbatimin e këtij ligji, konstatoi se e mbyll debatin për këtë çështje dhe se po vazhdojmë me Ligjin për skemat sociale të financuara nga shteti.

Skender Reçica, tha se sa i përket zbatimit të këtij ligji, aktet nënligjore që i parasheh ligji janë të kompletuara. MPMS-ja ka iniciuar procedurën për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuar nga shteti, i cili projektligj synohet të procedohet në Kuvend në nëntor të këtij viti.

Teuta Haxhiu, tha se jemi të shqetësuar me pensionet e familjeve, të dëshmorëve, personave të pagjetur, pensionet e moshës, po ashtu, ka fakte për persona 100% që janë të verbër. Persona që kanë të humbur dy apo tre fëmijë në luftë dhe është shumë e rëndë për ta të zgjedhin se cilin pension ta marrin, duhet të zgjedhin se për cilin anëtarë ta marrin pensionin, apo atë të

pleqërisë që është e drejtë elementare e tyre. Ajo theksoi se brenda mandatit të saj, nuk do të ndalet së kërkuari, deri në rregullimin e kësaj çështje.

Më tej përmendi se edhe Ligji për personat e verbër në një nen thekson që pavarësisht të hyrave të tjera, atyre ju takon pensioni.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është shqetësuese që një prind të zgjedh mes dy pensioneve, duke e ditur se Ligji për skemat pensionale nuk lejon një gjë të tillë, por nga ana tjetër Ligji për kategoritë e luftës e lejon një gjë të tillë. Ketë çështje e kam ngrit edhe në Kuvend.

Më tej ajo u interesua të dijë për më shumë aspekte për këto çështje, me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për skemat sociale.

Skender Reçica, tha se lidhur me këtë detyrim ligjor ashtu siç parashihet në këtë ligj, nuk është ndier mirë si ministër, por janë duke zbatuar një ligj që është në fuqi. Por, ai theksoi se me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, kjo çështje do të rregullohet.

Minire Begaj, tha se ligjet ua ndalojnë marrjen e më shumë se një pensioni dhe se baza ligjore ekziston, deri sa të ndryshohet ligji, këto nene janë në zbatim dhe jemi të obliguar ti aplikojmë. Sa i përket ndryshimit të ligjit jemi duke e shqyrtuar mundësinë, se si të bëhet zgjidhja më e mirë e çështjes së pensioneve për kategoritë e luftës.

Frashër Krasniqi, tha se të gjitha këto çështje që u parashtruan këtu janë si rezultat i implikimeve buxhetore, dhe sa herë ka probleme me buxhet, barra bie në kategoritë e skemave sociale dhe jo në kategori tjera që më shumë e shfrytëzojnë buxhetin.

Më tej theksoi se këto ligje janë miratuar në Kuvend dhe se ju i keni votuar ato ligje apo grupet tuaja parlamentare.

Teuta Haxhiu, tha se këtu po bëhet fjale për ligjet që shpeshherë bien në kundërshtim me njëri-tjetrin. Është Ligji për kategoritë e luftës, Ligji për personat e verbër, Ligji për skemat sociale, Shumë herë Ligji i punës bie në kundërshtim me shumë ligje të tjera, dhe se për të gjitha ekzistojnë procesverbalet dhe çdokush mund të njoftohet lidhur me këto çështje.

Frashër Krasniqi, tha se dallimet politike i kemi të gjithë, kontradiktat mes ligjeve vinë për shkak të implikimeve buxhetore dhe fola vetëm për këtë pjesë, sa herë del problem me buxhet preken skemat sociale.

Albulena Balaj, tha se e përgëzon ministrin për punën që është duke e bërë, ndërsa pas raportimeve që bëri këtu ministri, debati në komision në mes veti, duket sikur i kotë.

Skender Reçica, tha se ligjet bien ndesh shpesh herë mes veti, dhe kemi shumë punë në harmonizimin e tyre.

Ai theksoi se kur e ka marre postin ministror, e ka gjetur Ministrinë me 30 milionë euro minus, por prioritet i tij është avancimi i politikave në fushëveprimin e saj.

Bahri Xhaferi, theksoi se me ndryshim plotësimin e Ligjit për skemat sociale kemi paraparë që kategoritë e dala nga lufta, pjesa dërmuese e tyre të kenë të drejtën e përfitimit edhe të

pensionit tjetër. Pra i kemi kushtuar rendësi të veçantë përcaktimit të drejtë të kriterëve për përfitimin e pensionit tjetër.

Mexhide Mjaku-Topalli, në qofte se një familje ka tre apo me shumë persona të zhdukur ndërsa marrin mjete vetëm për një anëtar, atëherë a është menduar si të kategorizohen familjet që kanë më shumë anëtarë të zhdukur. Po ashtu, për familjet që janë në asistencë sociale, dihet që fëmija i tyre sapo të mbush 5 vjet, familja largohet nga skema sociale, çka do të bëni me këto familje dhe a do të këtë ndryshim Ligji për shërbimet sociale dhe Ligji për skemën e ndihmës sociale.

Bahri Xhaferi, tha se me ndryshim plotësimin e këtij ligji do t'ua njohim të drejtën, por si do të bëhen pagesat kjo bëhet me ligj tjetër.

Skender Reqica, theksoi se ato familje që janë me asistencë sociale dhe në ditën kur fëmija i mbush 5 vjet, më nuk e gëzon këtë të drejtë, e kuptoj që familjes në atë kohë vetëm i rriten shpenzimet, por edhe kjo është e rregulluar kështu me ligj.

Jemi në përfundim të një strategjie për punësim dhe do të angazhohemi që këta qytetarë të angazhohen në ndonjë punë, apo tu vazhdohet mbështetja financiare sepse nuk mundemi ti lëmë pa asnjë të ardhur.

Izedin Bytyçi, tani jemi duke përgatitur agjendën legjislativë për vitin e ardhshëm pritet të ndërhyjmë në Ligjin për shërbime sociale dhe Ligjin për asistencë sociale, dhe jemi duke insistuar të parashohim grantin specifik për shërbime sociale, i cili do të ndahet për komuna, në mënyrë që komunat të jenë në gjendje ti mbështesin sa më shumë shërbimet sociale.

Duda Balje, në fund të diskutimeve për këtë projektligj, e falënderoi ministrin për raportimin e bërë lidhur me zbatimin e këtyre ligjeve.

3.Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë

Duda Balje, tha se ky projektligj dihet se ka qenë pjesë e programit të punës së Kuvendit nga legjislatura e kaluar, i cili nuk ka arritur të miratohet në parim, në seancë plenare.

Ajo theksoi se ky projektligj i plotëson kriteret për të proceduar për shqyrtim të parë në seancë, ndërsa në vazhdim ftoi përfaqësuesit nga Zyra e Kryeministrit, për ta paraqitur këtë projektligj.

Agron Gashi, përfaqësues i zyrës ligjore të kryeministrit, bëri një rezymë të punës në këtë projektligj.

Si zyrë ligjore kemi organizuar shumë takime, ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e bashkësive fetare, organizata që veprojnë në Kosovë, ambasada të ndryshme dhe aktorë të tjerë.

Më pas, ai tha se me këtë projektligj rregullohet statusi juridik i bashkësive fetare, ynohet të njihet edhe një bashkësi e re fetare, ajo e bashkësive të tarikateve të Kosovës, pastaj rregullohet edhe çështja e regjistrimit të bashkësive të reja fetare, zgjidhjes së çështjes së varrezave të disa bashkësive fetare, si të kishës protestante dhe çështja e financimit të bashkësive fetare.

Haki Shatri, tha se ka dy rekomandime në emër të kryeministrit, që të bëhen dy ndryshime në draftin e projektligjit që e ka proceduar qeveria, kërkohet të fshihet te neni 12 A paragrafi 3,

qeveria nuk financon asnjë bashkësi fetare, dhe kërkesa e dytë ka të bëjë me nenin 7 B paragrafi 2.2, të bëhet ky ndryshim: Me rastin e themelimit të paraqesin listën me anëtarë, shtetas të moshës madhore të Republikës së Kosovës, pra të hiqet numri 50 anëtarë, mos të ketë kufizime.

Teuta Haxhiu, tha se kërkesa e dytë që u përmend këtu ka qenë vërejte legjislaturën e kaluar edhe nga anëtarët e komisionit, ndërsa pajtohet me të dy propozimet por si komision besoj se do të kryejmë punën në mënyrën më të mirë të mundshme.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se çështja që e kemi shqyrtuar mandatin e kaluar kanë qenë dy nene pikërisht që ju lejohet të regjistrohen me 50 anëtarë, neni tjetër është neni 7B, sipas të cilit bashkësitë fetare nuk janë të detyruara të regjistrohen dhe të pranojnë statusin e personit juridik kundër vullnetit të tyre. Nëse ka mundësi me lëvizë me shifër numrin 50 anëtarë, atëherë mendoni si të bëhet edhe me pikën 1 të nenit 7 B regjistrimi i bashkësive fetare.

Frashër Krasnqi, tha se edhe mandatin e kaluar e kanë shqyrtuar këtë projektligj në kuadër të grupit parlamentar dhe subjektit politik që përfaqëson, dhe kanë parë probleme në këtë projektligj.

Jemi për lirinë fetare dhe për trajtim të barabartë të të gjithëve, madje që shteti të angazhohet të garantoj këtë liri, por mendojmë se ka një problem te neni 4A, problem ky që përbën edhe diskriminim edhe etnizim për bashkësitë tjera fetare. Kemi kodifikim që kisha ortodokse të jetë serbe, kjo është e papranueshme dhe duhet të rregullohet, sepse kjo e kushtëzon të qenit pjesë e bashkësisë fetare ortodokse në Kosovë me të qenit e etnitetit serb. Nëse marrim shembull, që një shqiptar dëshiron të jetë i përkatësisë fetare ortodokse, ai para së gjithash duhet të bëhet pjesë e etnitetit serb, dhe ne dimë si funksionon kisha ortodokse në Kosovë, dhe përbën edhe cenim të sovranitetit dhe trashëgimisë kulturore.

Ai shtoi se sa i përket regjistrimit me 50 nënshkrime edhe ashtu e kemi konsideruar absurde, por është problem të hiqet kriteri sasior. Nuk mund ta lëmë krijimin e një komuniteti në kompetencë të një komisioni që e krijon qeveria sepse, kjo mund ta lë të hapur që ky komision të vendos të krijojë komunitet edhe nëse i ka vetëm 10 anëtarë. Kemi shembuj në vende të ndryshme, për shembull, Austria, kur një komunitet i caktuar formohet nëse i takon 2% e popullsisë së përgjithshme. Pranojmë të ekzistojë një modalitet por jo të hiqet komplet kriteri.

Teuta Haxhiu, tha se komisioni që do të jete pranë zyrës së kryeministrit duhet të jetë profesional, pavarësisht se nga kush emërohet. Ajo ngriti çështjen e bashkësisë bektashiane të cilin shqetësim tha se ka pasur edhe legjislaturën e kaluar por për këtë çështje do të diskutojmë në Komisionin Funksional, pas miratimit në Kuvend.

Agron Gashi, tha se sa i përket numrit të anëtarëve për regjistrim të bashkësive fetare, ndoshta më mirë do të ishte të jenë 2000 anëtarë, e me shumë, por numri më i vogël është lënë, me qëllim që tu jepet mundësia për tu regjistruar.

Lirije Kajtazi, tha se te çështja e fondeve nuk më është dukur as pak problem, por, do të vendosim së bashku. Dihet se edhe në Maqedoni ekziston problem i tillë, sa i përket të drejtës fetare, kushtetuta ua garanton por ligji ua kufizon dhe tani ka shqiptarë ortodoks të cilët po

kërkojnë që të ushtrojnë të drejtën e tyre fetare dhe këto çështje janë në shqyrtim edhe në Gjykatën Kushtetuese të këtij shteti.

Saranda Bogujevci, tha se nuk mundet një komunitet me qenë aktiv pa u pranuar, ne si komision duhet të kemi kujdes këtu sepse të çështja e komunitetit ortodoks mund të ketë probleme.

Duda Balje, theksoi se pas miratimit në parim në Kuvend, anëtarët e Komisionit FunkSIONal, në fazën e amendamentimit do të punojmë së bashku me të gjithë partnerët që na mbështesin.

Ajo, më pas, i ftoi për votim anëtarët e Komisionit për miratimin në parim të këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte:

Për - 7 deputetë,
Abstenim - 0 deputet,
Kundër - 0.

Më pas, kryetarja, konstatoi se Komisioni FunkSIONal, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë.

5. Të ndryshme.

Frashër Krasniqi, tha se në rendin e ditës nuk ishte cekur se për çka do të raportojë ministri në komision, është mirë në të ardhmen të kemi parasysh këtë.

Duda Balje, tha se e kemi diskutuar në komision në mbledhjen e kaluar se për cilat tema do të jetë i ftuar ministri për raportim.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje